



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUIJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë , me 18.09.2024

PROCESVERBAL – KONTRATE MALLI
ME OBJEKT

“BLERJE DETERGJENTË PËR BASHKINE KRUIJË”

**PËR ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot me date 18.09.2024 ne Kruje , nga ana e Njesise se Prokurimit ngritur me urdherin nr.348 datë 16.09.2024 me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Detergjentë për Bashkine Krujë dhe institucionet e varesise”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Detergjentë / (39831200-8).**

- 1. VLERA E FONDIT LIMIT: prej 2'378'104 (dy milion e treqind e shtatedhete e tete mije e njeqind e kater) lekë pa tvsh**

BURIMI FINANCIMIT :TE ARDHURAT E BASHKISE KRUIJE .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

- 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (ne masen 2% te vleres se fondit limit te kontrates)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2024 të njohura nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2024 për secilin operator)*

Shenim-Per të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë:

- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2024 të leshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2024 për secilin operator).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe kërkesave specifike të Ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të

taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kritereve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

a) Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklaramit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2021,2022,2023) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te kontrates, qe prokurohet përkatësisht ne shumen prej **951’242(nenteqind e pesedhjte e nje mije e dyqind e dyzet e dy) leke pa t.v.sh**

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur edhe vertetimin perkates te Administrates Tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43.2.c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë neëkohe dhe në përputhje me specififikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike

Vlera e marzhit te xhiros se kerkuar ne kufirin e percaktuar si me siper konsiderohet tregues i rendesishem per kapacitetin financiar te Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marre ne analize edhe faktin se vlera e fondit limit eshte e nje kufiri te ulet dhe iu jep mundesine nder te tjera e dhe operateve ekonomik te vegjel dhe te mesem te kene akses ne oferte.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

22.3-1. Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit me një vlerë jo me te vogel se 20 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht jo me pak se vlera **475’621 (katerqind e shtatedhjte e pese mije e gjashteqind e njezet e nje) leke pa t.v.sh,**dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Vlera në kufirin e përcaktuar në VKM nr 285 datë 19.05.2021, është përcaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkinë Krujë), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.3-a) Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizojë/transportojë dhe të mallrat objekt kontrate, në vendet e përcaktuara nga ana e Bashkisë Krujë me mjetet e tij që ka në dispozicion sipas kërkesës së AK. (Deklarate të lëshuar nga Administratori i shoqërisë).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku thuhet se ... **Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurimet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.** Disponueshmëria e furnizimit nga ana e OE është kërkesë ekzigjente nga ana e AK, pasi mallrat objekt prokurimi, i shërbejnë jo vetëm institucionit të Bashkisë Krujë por edhe objekteve arsimore të varesisë së këtij institucioni e për pasojë përmbushja në

kohe dhe disponibiliteti ne furnizim eshte domosdoshmeri per realizimin me sukses te kontrates.

2.3.2-Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ ekuivalent e lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas DST , janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Lista e artikujve te cilet do blihen jane si vijon te detajuara me specifikimet teknike perkatese

N R	EMËRTIMI I MATERIALEVE	NJËSIA	SASIA	7 DITE	7 DITE
1	Solucion per larje pllakash	cope	2000		-
2	Aromatik per larje pllakash	copë	2650		-
3	Acid për pastrim pllakash.	copë	200		-
4	Fshesa dyshemeje me fije të gjatëplastike	copë	800		-
5	Lecka larjeje	copë	800		-
6	Fshesa për rrjetat e merimangave.	copë	100		-
7	Kova për leckat për larje dyshemeje.	copë	100		-
8	Kosha mbeturinash plastik, te hapur	copë	200		-
9	Kosha mbeturinash plastik , te mbyllur	cope	150		-
10	Kosha mbeturinash plastik,	copë	140		-
11	Doreza Ilastiku larjeje.	copë	250		-
12	Doreza pastrimi.	copë	900		-
13	Sapun I lengshem	copë	150		-

14	Sapuna të thjeshtë.	copë	90		-
15	Detergjent për pastrim xhamash	copë	500		-
16	Detergjent pluhur për larje rrobash.	pako	100		-
17	Lopata plastike.	copë	260		
18	Detergjentë për pastrim enësh	copë	800		
19	Tel enësh I trashë guzhine.	copë	150		
20	Sfungjer enësh	copë	300		
21	Peshqirë duarsh mesatarë.	copë	100		
22	Qese plastike të zeza për kosha të mëdhenj.	pako	1600		
23	Furçe plastike për pastrim WC-je.	copë	90		
24	Bishta druri per fshesa dhe lecka.	copë	1000		-
25	Kartopiceta duarsh rrul	copë	600		
26	Kartopiceta duarsh katrore	copë	400		
27	Letra higjenike	copë	610		
28	Amoniak	cope	40		
29	Furce per larje xhamash	cope	40		
30	Lecka per pastrim pluhurash	cope	20		
31	Solucion per larje mobiliesh	cope	20		
32	Mbajtese sapuni per banjo	cope	6		

- Hartimi i specifikimeve teknike për blerjen e artikujve higjenosanitare-detergjente sipas listes së miratuar në preventivin përkatës është bërë duke iu referuar shkresës së Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe Sportit nr. **5524 Prot, datë 06 .09.2024**, duke identifikuar për çdo pajisje specifikimin dhe karakteristikat përkatëse teknike të cilat plotësojnë nevojat respektive të Bashkisë Krujë dhe Institucioneve Arsimore Publike të varesive.
- Sa i përket standartit të tyre për çdo artikull ato janë hartuar duke marrë në konsideratë përcaktimet respektive sipas artikujve dhe standartit të pranuar të tregut si dhe kërkesat përkatëse të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".
- Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

- **Fondi limit** per proceduren me objekt “**Blerje Detergjentë për Bashkinë Krujë dhe Instituciove te varesise**”, eshte hartuar duke iu referuar cmimeve te tregut per kategorin e mallrave/artikujve te ngjashem ,sipas referimeve dhe metodave te parashikuara ne nenin 76.c te Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 , “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.